



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2019:278575

Datë: 21.03.2024

Numri i dokumentit: 05486955

C.nr.359/2019

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, në çështjen juridike kontestimore të paditësit I.C nga Rahoveci, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati R.H nga Rahoveci, ndaj të paditurit M.D nga Rahoveci, për shkak të objektit të kontestit – kompensimi dëmi, me vlerën e objektit të kontestit prej 1,926.26 euro, jashtë seancës, më datën 21.03.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET e tërhequr padia e paditësit I.C nga Rahoveci, ndaj të paditurit M.D nga Rahoveci, në çështjen kontestimore C.nr.359/2019.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi I.C nga Rahoveci, përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, më datën 20.09.2019, në këtë gjykatë ka parashtruar padinë ndaj të paditurit M.D nga Rahoveci, për shkak të objektit të kontestit – kompensimi dëmi, me vlerën e objektit të kontestit prej 1,926.26 euro.

Lidhur me këtë çështje kontestimore, kjo gjykatë ka caktuar seancën përgatitore për datën 01.02.2024, në të cilën seancë kanë prezantuar përfaqësuesi i autorizuar i paditësit dhe i padituri. Më datën 01.03.2024, përfaqësuesi i autorizuar i paditësit ka dorëzuar parashtresën me të cilën është tërhequr nga padia. Gjykata, të paditurit i ka dorëzuar parashtresën me të cilën paditësi është tërhequr nga padia, por përkundër faktit se ka kaluar afati 7 ditor nga dita e pranimit të saj, i njëjti nuk është deklaruar lidhur me tërheqjen e padisë.

Kështu, sipas nenit 261.1 të LPK-së “*Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi*”. Ndërsa sipas nenit 261.2 “*Padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë*”.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale, që secila palë t'i bartë këto shpenzime, është marrë në kuptim të nenit 456.1 të LPK-së.

Prandaj, nga ajo që u tha më lartë, kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e në bazë të nenit 261.2, 262.3 dhe 262.4 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

C.nr.359/2019, më datën 21.03.2024

Gjyqtari
Berkan Hamza

KËSHILLË JURDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit.